



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

Oda e Mjekëve të Kosovës –Kosovo Doctors Chamber – Lekarska Komora Kosova

NJOFTIM PËR KONTRATË

☐ FURNIZIM

☒ SHËRBIME

☐ PUNË

Data e përgatitjes së njoftimit: 23/02/2026

Nr. i Prokurimit	01-26
------------------	-------

Ky njoftim është përgatitur në GJUHËN:

Shqipe

NENI I: AUTORITETI KONTRAKTUES

I.1) EMRI DHE ADRESA E AUTORITETIT KONTRAKTUES (AK)

Emri i AK:	ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS		
Adresa e AK:	Instituti A, QKUK, Kati 2, 1000 Prishtinë		
Adresa elektronike:	info@omk-rks.org www.omk-rks.org	Kodi postar i qytetit të AK:	10 000
Personi kontaktues:	Pajtime Vllasa	E-mail:	pajtime.vllasa@omk-rks.org
Telefoni fix:	038544872	Mob:	049872305

Kontrata përfshinë prokurimin e përbashkët

Po ☐ Jo ☒

Kontrata shpërblehet nga Oda e Mjekëve të Kosovës

Po ☒ Jo ☐

NENI II: LËNDA E KONTRATËS

II.1) PËRSHKRIMI

II.1.1) Titulli i kontratës i dhënë nga autoriteti kontraktues:

Kontratë për Shërbimet e Mirëmbajtjes për Platformën e Odës së Mjekëve të Kosovës

II.1.2) Lloji i kontratës dhe vendi i dorëzimit apo realizimit

(Zgjidhni vetëm një kategori - furnizime apo shërbime – e cila korrespondon më së shumti me objektin specifik të kontratës suaj)

☐ Furnizime	☒ Shërbime	☐ Punë
☐ Blerja ☐ Qira financiare(lizing) ☐ Qira ☐ Blerje mekëste ☐ Një kombinim ikëtyre		☐ Riparim ☐ Mirëmbajtje

Vendi apo vendndodhja kryesor i dorëzimit/ kryesor i realizimit

Oda e Mjekëve të Kosovës, Instituti A, QKUK, Kati 2, 10 000 Prishtinë

II.1.2) Përshkrim i shkurtër i lëndës së kontratës

Qëllimi i kësaj kontrate është sigurimi i mirëmbajtjes teknike, funksionale dhe të sigurisë për platformën ekzistuese të Odës së Mjekëve të Kosovës, duke garantuar stabilitet, siguri dhe performancë të vazhdueshme. Nënshkrimi i kontratës publike kornizë është obligim për Autoritetin Kontraktues.

II.1.3) Klasifikimi i Fjalorit të Përgjithshëm të Prokurimit (FPP):

N/A

II.1.5) Variantet pranohen

Po ☐ Jo ☒

II.1.6) Ndarja në Pjesë

Po ☐ Jo ☒

Nëse po, tenderët mund të dorëzohen për *(shënoni vetëm një kuti)*

☐ vetëm një pjesë.

☐ Të gjitha pjesët

II.1.7) Informacione lidhur me pjesët *(nëse aplikohen)*

N/A

II.1.8) Vlera e parashikuar e kontratës:

20,000.00€, varësisht nga shërbimet e kërkuara shuma e kontratës mund të rritet për max 10% të vlerës së përgjithshme të saj.

II.2) SASIA APO FUSHËVEPRIMI I KONTRATËS

Sasia apo fushëveprimi i përgjithshëm (përfshirë të gjitha pjesët dhe opsionet nëse aplikohen)

II.3) KOHËZGJATJA E KONTRATËS APO AFATET KOHORE PËR PËRFUNDIM

Afatet kohore për nisje dhe/apo përfundim të kontratës: 3 vite nga data e nënshkrimit të kontratës.
Fillimi: 24/03/2026; Data e fundit për përfundim: 23/03/2029;

NENI III: INFORMACIONET LIGJORE, EKONOMIKE, FINANCIARE DHE TEKNIKE III.1) KUSHTET NË LIDHJE ME KONTRATËN

III.1.1) Forma ligjore që do të merret përmes grupit të operatorëve ekonomik të cilëve do t'u jepet kontrata (nëse aplikohet):

III.1.2) Kushtet e tjera të veçanta me të cilat ka të bëjë ekzekutimi i kontratës

Po ☐ Jo ☒

Nëse po, përshkrimi i kushteve të veçanta

III.2) KUSHTET PËR PJESËMARRJE

Pranueshmëria e Operatorëve Ekonomik		Përveç deklaratës së shkruar nën Betim, e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formën në Aneksin 2, dëshmitë lidhur me kërkesat e pranueshmërisë do të kërkojnë nga tenderuesi të cilit autoriteti kontraktues ka ndër mend që t'ia jap kontratën. Këto dokumente duhet të dorëzohen nga tenderuesi para dhënies së kontratës. Në rast të dështimit të dorëzimit të këtij dokumenti, tenderi në fjalë do të refuzohet Dokumentet të cilat do të kërkojnë si dëshmi për përmbushje të kërkesave të pranueshmërisë janë me se vijon: a. Vërtetim i lëshuar nga Administrata Tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është delikuent (shkelës) në pagesën e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit [para datës së publikimit të Njoftimit të Kontratës] Në lidhje me dispozitat e tjera të përcaktuara në Nenin 6 si dhe në rastin kur lëshimi i dokumenteve dhe certifikatave që referohen më lart është i pamundshëm për arsye objektive, apo kur dokumentet nuk mbulojnë të gjitha rastet për të cilat është nxjerrë dëshmia, një deklaratë nën betim nga tenderuesi mund të pranohet si dëshmi e mjaftueshme.
Pranueshmëria e Operatorëve Ekonomik		Kërkesa 1. Një dokument nga Administrata Tatimore e vendit tuaj të themelimit, se ju nuk jeni me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit para datës së publikimit të Njoftimit të Kontratës.
		Dëshmia 1. Vërtetimin nga Administrata Tatimore (kopje). Dokumenti (nën 1) duhet të dorëzohet vetëm nga tenderuesi fitues, para publikimit të dhënies së kontratës. Në rast të dështimit të dorëzimit të dokumentit, tenderi i juaj do të refuzohet dhe AK do të vazhdojë me tenderuesin e listuar të radhës.
Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale		Kërkesa 1: Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe apo regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit NUI; Kërkesa 2: Deklarues i TVSH-se (nëse është). Kërkesa 3: Vërtetim që nuk është në procedurë falimentimi

		Dëshmia 1: Një dokument i lëshuar nga autoriteti përkatës publik në vendin e themelimit të operatorit ekonomik me të cilin evidentohet regjistrimi i operatorit ekonomik në atë vend (certifikata e biznesit NUI - Kopje); Dëshmia 2: Certifikata e TVSH-së - vlenë për kompaninë vendore Dëshmia 3: Vërtetim që nuk është në procedurë falimentimi
Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare		Kërkesa 1: Operatori ekonomik duhet të ketë realizuar gjatë tri viteve të shkuara një xhiro totale vjetore në EURO të barabartë ose më shumë se: 30,000.00 €
		Dëshmia 1: Deklaratat Tatimore Vjetore të dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës për tri vitet e shkuara ose vërtetim të lëshuar dhe vërtetuar nga ATK-ja mbi qarkullimin financiar në tri vitet e shkuara ose gjendje e përgjithshme deri në datën e Njoftimit për kontratë të lëshuar dhe vërtetuar nga ATK.
Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale		Kërkesa 1: Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses shërbime të mirëmbajtje platformash softuerike gjatë tri viteve të fundit (duke filluar nga data e publikimit të këtij njoftimi për kontratë), qarkullimi duhet të tejkaloj ose të jetë i barabartë me 30,000.00 €. Kërkesa 2: Operatori ekonomik duhet të ketë se paku 3 (tre) punëtorë të kualifikuar përgjegjës për sigurimin e shërbimeve të cilët duhet të jenë Menaxher Projekti – 1 person (Diplomë në IT ose fushë relevante, minimum 5 vite përvojë profesionale, minimum 3 vite përvojë në menaxhim projektsh IT), Zhvillues Senior – 1 person (minimum 5 vite përvojë në zhvillim software, përvojë në teknologjinë ekzistuese të platformës (të specifikohet p.sh. .NET, Java, PHP, etj.), minimum 2 projekte të ngjashme), Zhvillues / Inxhinier Mbështetës – 1 person (minimum 3 vite përvojë, përvojë në mirëmbajtje aplikacionesh), Administrator Sistemi / Database – 1 person (Minimum 3 vite përvojë, përvojë me serverë dhe databaza relevante, Certifikime profesionale avantazh).
		Dëshmia 1: Kopje e dëshmimeve të pagesave (Raport të transfereve) që janë bërë nga operatori ekonomik shërbime të mirëmbajtje platformash softuerike përkatëse apo qfarëdo dëshmie tjetër që dëshmojnë lehtësisht qarkullimin e kërkuar. Dëshmia 2: CV, Certifikatave/diplomave të punëtorëve të kualifikuar si dhe kopjet e kontratave të punës të punëtorëve të kërkuar (ose parakontrata), dhe duhet të dëshmojnë përvojën e së paku 6 muaj në shërbime të ngjashme me dëshmi të pageses së kontributit pensional në FKPK (Trusti). OE mundën të aplikojnë edhe me staf që kanë para-kontrata.

III.3) KUSHTET SPECIFIKE PËR KONTRATAT E SHËRBIMEVE Po ☒ Jo ☐

III.3.1) Ekzekutimi i shërbimeve i rezervuar për një profesion të caktuar

Nëse po, referenca për ligjin, rregulloren apo dispozitën administrative përkatëse

III.3.2 Personat ligjor duhet të tregojnë emrat e kualifikimeve profesionale të personelit përgjegjës për ekzekutimin e shërbimeve

Po ☒ Jo ☐

NENI IV: PROCEDURA

IV.1) LLOJI I PROCEDURËS

IV.1.1) Lloji i procedurës
☒ Procedurë e hapur
☐ Procedurë e kufizuar
☐ Procedurë e negociuar
☐ Prokurim njëburimor
☐ Tender ndërkombëtar

IV. 1) KRITERET E DHËNIES

☐ Çmimi më i ulët ose
☒ Çmimi ekonomikisht më i favorshëm dhe konformiteti cilësor i shërbimit të ofruar

IV.2) INFORMACIONET ADMINISTRATIVE

IV.3.1) Publikimet paraprake në lidhje me kontratën e njëjtë Po ☒ Jo ☐ Nëse po, Po ☐ Jo ☒ Dokumentet me pages
IV.3.2) Afati i fundit për pranim të tenderëve /aplikacioneve: data 10/03/2026, koha 12:00, vendi Instituti A, QKUK, Kati 2, Prishtinë
IV.3.3) Periudha e vlefshmërisë së tenderit: Kuotimi i çmimeve do të jetë i vlefshëm për 30 ditë nga afati i dorëzimit të kuotimeve të çmimit për hapjen e tenderit.
IV.3.4) Takimi për hapjen e tenderëve: Data: 10/03/2026 koha: 12:00 vendi Instituti A, QKUK, Kati 2, Prishtinë

NENI V: INFORMACIONET PLOTËSUESE

V.1) ANKESAT

Çdo palë e interesuar mund të bëjë ankesë pranë Autoritetit Kontraktues.

Në pajtim me Nenin 20, paragrafin 1 të Rregullores për Procedurat e Prokurimit në OMK, pala me interes juridik, respektivisht ofertuesi i interesuar ka të drejtë ankese: Lidhur me ofrimin e dosjes së tenderit në procedurë të njoftimit të kontratës;

Lidhur me vlerësimin të ofertave, respektivisht njoftimit për dhënie të kontratës; dhe Parashtrimin e ankesës për anulim të procedurës së prokurimit. Për cilëndo fazë dhe arsye të parashtrimit të ankesës, të njëjtat duhet të parashtrohen në afat prej 5 (pesë) ditëve nga dita kur palët janë njoftuar, respektivisht kur është bërë njoftimi zyrtar lidhur procedurën e zhvilluar.

Ankesat e ofertuesve parashtrohen pranë Këshillit Drejtues të Odës, i cili do të vendos për ankesat eventuale, jo më larg se 30 ditë nga dita kur është dorëzuar ankesa. Përfshirë nga rastet të tjera, vetëm ankesa ndaj njoftimit për dhënie të kontratës e pezullon procedurën e prokurimit

V.2) INFORMACIONET SHITESË

Shënim: Operatorët ekonomik do të kenë të drejtë të dorëzojnë tenderin, kërkesën për pjesëmarrje dhe dokumentet e tjera të nevojshme apo dosjet të cilat u lejohen gjatë kryerjes së një aktiviteti të prokurimit në gjuhën shqipe.